

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK**

Komisioni i Përherëshëm i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 06 datë: 29/09//2025

Nr. _____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. _____ datë 29 / 09 2025,
relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin

“PËR SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKB-NË NR.86 DATË 12.12.2024 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025”.

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe VKB nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025”, i ndryshuar”

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Në mbështetje të Vendimit nr 20, datë 05.03.2021, të Këshillit Bashkiak me objekt “Për miratimin e shpërndarjes të trashëguarës në buxhetin 2021”, Bashkia ka akorduar fond buxhetor për implementimin e projekteve me financim të huaj në shumën 16 286 015 lekë. Nga fondet e akorduara, për implementimin e projekteve të huaja janë përdorur fondet në shumën 16 096 797 lekë. Përdorimet e fondeve janë të orientuara drejt shpenzimeve operative, stafit të jashtëm dhe shpenzimeve kapitale. Pas vlerësimit të performancës së shpenzimeve të realizuara nga implementimi i projekteve “Green Point Mob”, “Prosfora” dhe “Herbino” pranë Bankës së Shqipërisë në depozitat e qeverisë në euro janë rimbursuar fondet përkatësisht:

1. Herbinno në shumën 306 260.10 lekë
2. Prosfora në shumën 1 680 981.35 lekë

Fondet e përfituara si rimbursim i shpenzimeve pas vlerësimit të performancës së implementimit të projekteve rezultojnë në shumën totale 1 987 241.45 lekë.

Në mbështetje të ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” Udhëzimit plotësues nr 01, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” , pika 33, *“Për njësitë e qeverisjes vendore, që kanë përdorur të ardhurat e veta për financimin e projekteve, fondi i rimbursuar nga donator/kreditori pas vlerësimit të performancës së projekteve në fjalë, i kalon njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore që ka kryer shpenzimin nga të ardhurat e veta, në masën e shpenzimit të kryer, dhe përdoret prej saj si e ardhur”* .

Gjithashtu në zbatim të projektit Projekti CLEAN (CLimate changE covenANt of mayor) me qëllim të kontribuojë duke promovuar efikasitetin e energjisë në të gjithë rajonin, duke përfituar nga përvojat e fituara nga Marrëveshja e Kryetarëve të Bashkive të BE-së për Klimën dhe Energjinë (CoM) - rrjet me më shumë se 11.600 qytete.

Ky rrjet kërkon që nënshkruesit të përgatisin një "Plan Veprimi për Energjinë dhe Klimën e Qëndrueshme" (SECAP). Partnerët nga të dyja anët e Adriatikut do të analizojnë politikat dhe praktikat më të mira duke u përqendruar në politikën e energjisë të BE-së dhe, në veçanti, Direktivën për Eficiencën e Energjisë (EED) me propozimet e fundit për reforma (Mars 2023). Në këtë drejtim, SECAP-et (Sustainable Energy and Climate Action Plan) përfaqësojnë mjetin e përsosur për planifikim të qëndrueshëm territorial, pasi ato përputhen me parimin "efikasiteti i energjisë në radhë të parë" të përcaktuar në EED, i cili kërkon që masat e efikasitetit me kosto efektive duhet të jenë nxitësi kryesor i politikave dhe investimeve në energji.

- Shpenzimet kapitale

Në mbështetje të shkresës nr 3964/1, datë 02.07.2025, “Kthim përgjigje”, shkresës nr 8016, datë 20.07.2022 “Dërgohet çelja e fondeve në grupin e shpenzimeve kapitale për vitin 2022-2023”, shkresës nr 7290, datë 30.06.2022 “Njoftim për shpalljen fituese të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin” nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, objekti “Rikonstruksion i palestrës shkollë e mesme “Asim Zeneli”, baza prodhuese dhe shkollë “Drita” me vlerë të plotë 85,460,699 lekë nga të cilat 17,539,058 lekë bashkëfinancim nga bashkia dhe 67,921,641 lekë vlerë e financuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Kjo sipas Urdhërit nr 245, datë 09.05.2022 “Për shpalljen e

thirrjes për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollore e sportive, për njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektet me cikël financimi 2022-2023”, ku përcaktohet se; *“Diferenca mes vlerës së projektit me vlerën e kontratës nëse ka një të tillë pas prokurimit public do t’i zbritet financimit me burim fondet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, pjesë e fondeve për financimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive”*, por gjatë angazhimit të kontratës ky përcaktim nuk është konsideruar si rezultat i mos njoftimit nga strukturat përkatëse dhe në këto kushte angazhimi në degën e thesarit është; 15,304,466.8 lekë bashkëfinancim i bashkisë dhe 70,156,232 lekë financim nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Në zbatim të Urdhërit nr 245, datë 09.05.2022 “Për shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollore e sportive, për njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektet me cikël financimi 2022-2023” bashkia rezulton se i detyrohet kreditorit vlerën 2,228,607.2 lekë, të cilat deri në momentin e njoftimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjetë shkresës nr 6571, datë 04.07.2025, konsideroheshin detyrim i kësaj të fundit kundrejt kreditorit.

Me qëllim krijimin e një hapësire miqësore, edukative dhe kreative për fëmijët, ku ata të lexojnë, mësojnë dhe zhvillojnë imagjinatën në një ambient modern, të rehatshëm dhe të sigurt propozohet që biblioteka e qytetit “Fato Berberi” të pajiset me mobilje funksionale dhe ergonomike (rafte për libra me lartësi të përshtatshme për fëmijët, tavolina e karrige të vogla), kënd leximi dhe lojëra edukative, dekorim tematik me ngjyra të gjalla, murale edukative dhe kënd kreativiteti për aktivitete. Fondi i parashikuar në buxhetin 2025 është i pamjaftueshëm për t’i dhënë bibliotekës së fëmijëve një ngjyrë tjetër dhe për këtë rast propozohet shtesë fondi me qëllim finalizimin e një projekti më gjithëpërfshirës se projekti fillestar.

- Shpenzimet utilitare dhe të tjera

Nga analiza e shërbimeve utilitare “energji elektrike” dhe “ujë” marrë në konsideratë e njëjta periudhë krahasimisht për dy vite 2024-2025 rezulton të ketë një rritje të ndjeshme të shpenzimit si rezultat i faktorëve, konsum i lartë për shkak të kushteve atmosferike, lidhje të reja kontratash, Duke qenë se fondi i miratuar në buxhetin vjetor nuk është i mjaftueshëm për përballimin e pagesave deri në fund të vitit krijohet nevoja e shtimit të fondit në mënyrë që institucioni të garantojë vijimësinë e punës normale dhe pagesën në kohë të detyrimeve kundrejt operatorit. Përveç shpenzimeve utilitare analizë është urshtruar edhe në shpenzime të tjera për të cilat lind nevoja për shtesë fondi në; Analiza uji dhe akte higjienosanitare dhe shpenzime për siguracion të mjeteve.

Në mbështetje të ligjit nr 22/2018 “Për strehimin social” ofrohet shërbimi i bonusit të qerasë për familjet në nevojë dhe për familjet që preken nga eriozoni i tokës në lagjen “Cfakë”. Fondi i parashikuar në buxhetin vjetor i planifikuar për bonusin e qerasë për familjet në nevojë ka mbuluar shpenzimet për të dyja kategoritë dhe si rezultat krijohet nevoja e shtesës së fondit me qëllim ofrimin e shërbimit social deri në fund të periudhës 2025.

- Dekorimi i Qytetit për Festat e Fundvitit

Objektivi është krijimi i një atmosfere festive, mikpritëse dhe atraktive për banorët e qytetit dhe vizitorët, duke nxitur gjallërimin e jetës sociale, ekonomike dhe kulturore gjatë periudhës së fundvitit.

Dekorimi i hapësirave kryesore urbane (qendra e qytetit, sheshi kryesor, rrugët kryesore, parqet dhe hapësirat publike) me elementë ndriçues dhe artistikë që reflektojnë gëzimin e festave.

Dekori do të përfshijë dekorimin e Pemën e Krishtlindjes (shumëngjyreshe, me drita LED të kursimit energjie), Ndriçim dekorativ në rrugët kryesore, Figura tematike (ylli, bora, drerë, shtëpiza festive), Stenda artizanale dhe treg i vogël festiv për promovimin e produkteve vendase, Kënd fotografik “Festive Spot” për qytetarët dhe turistët.

Investimi fillestar konsiston në blerjen e pajisjeve ndriçuese, figurave tematike, shpenzimet për montim dhe mirëmbajtje. Përfitimet e pritshme janë; rritja e frekuencimit të qytetit gjatë periudhës së festive, mbështetje për artizanët, gastronominë dhe tregtarët lokalë përmes tregut festiv, promovim turistik dhe gjallërim i ekonomisë vendase.

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimi nr 09. Date 23.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” VKB-së nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025”, propozohen ndryshime në buxhetin vjetor 2025 si më poshtë vijon;

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Pakësohet

Programi AD115 Kap.1 Art 231 me kod projekti P091AAD në vlerën 25.675.700 lekë.

Në kuadrin e menaxhimit të burimeve financiare, për fondet e përdorura nga projekti P091AAD *Masa inxhinerike për stabilizimin e rrëshkitjes së skarpatës kodra e Cjakës (ura e Nanxës-Ura Zerzebilit)* diferenca do të transferohet në vitin buxhetor 2026.

Shtohet

Programi AF115 Kap.1 Art 231 me kod projekti P923AAA në vlerën 2.228.700 lekë.

Programi AE115 Kap.1 Art 602 me kod projekti V626AAI në vlerën 5.000.000 lekë.

Programi AF115 Kap.1 Art 231 (*materiale per mobilim ambientesh*) me kod projekti V912AAF në vlerën 500.000 lekë.

Programi AA115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V111AAD në vlerën 1.510.000 lekë.

Programi AB115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V043AAA në vlerën 150.000 lekë.

Programi AC115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V822AAC në vlerën 1.100.000lekë.

Programi AC115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V823AAB në vlerën 150.000lekë.

Programi AD115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V328AAC në vlerën 130.000 lekë.

Programi AE115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V626AAF në vlerën 100.000 lekë.

Programi AE115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V644AAB në vlerën 9.000.000 lekë.

Programi AF115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V912AAB në vlerën 2.200.000 lekë.

Programi AF115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V923AAB në vlerën 850.000 lekë.

Programi AG115 Kap.1 Art 602 (*energji elektrike*) me kod projekti V424AAE në vlerën 337.000 lekë.

Programi AA115 Kap.1 Art 602 (*ujë*) me kod projekti V111AAD në vlerën 180.000 lekë.

Programi AB115 Kap.1 Art 602 (*ujë*) me kod projekti V043AAA në vlerën 90.000 lekë.

Programi AD115 Kap.1 Art 602 (*ujë*) me kod projekti V328AAC në vlerën 100.000 lekë.

Programi AE115 Kap.1 Art 602 (*ujë*) me kod projekti V626AAF në vlerën 50.000 lekë.

Programi AE115 Kap.1 Art 602 (*ujë*) me kod projekti V626AAB në vlerën 740.000 lekë.

Programi AF115 Kap.1 Art 602 (*ujë*) me kod projekti V912AAB në vlerën 510.000 lekë.

Programi AF115 Kap.1 Art 602 (*ujë*) me kod projekti V923AAB në vlerën 450.000 lekë.

Programi AG115 Kap.1 Art 602 (*ujë*) me kod projekti V424AAE në vlerën 300.000 lekë.

- Bashkia Gjirokastrë është partnere në projektin *CLEAN*, me një buxhet total prej **36,607.00 €**.

1. Workshop, seminare dhe konferenca (workshops/seminar/and conferences) - 26,928.00 €

Bashkia Gjirokastrë do të organizojë 2 (dy) Workshop/ seminar/ dhe konferenca me buxhet dedikuar prej **13,464.00 € (për aktivitet), 26,928.00 €** në total.

2. Plan veprimi (Action plan/Model/Methods (ApMM)) - 9,679.00 €

Bashkia Gjirokastrë do të zhvillojë Planin e veprimit (*Action Plan*) me buxhet dedikuar prej **9,679.00 €**.

Drejtorja / Sektori përgjegjës .

Drejtorja e Finances

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, sipas pershkrimeve ligjore dhe sa here ai e shikon te nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Ky projrkt vendim impakton te gjitha shtresat dhe kategorite e komunitett te bashkise Gjirokaster si dhe zhvillimin ekonomik te krejt territorrit te kesaj bashkie.

A është objekt i konsultimit publik:

PO

Komisioni i Përhershëm i i **“Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”**

i mbledhur me datën 29 / 09 /2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. _____ datë 29 / 09 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin:

“PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB-NË NR.86 DATË 12.12.2024 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025”, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë vótash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim


☒ b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

- ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
- ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
- ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
- ✓ Paragrafi x (iks) i projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në
proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit



Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Datë 29 /09/ 2025

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK**

Komisioni i Përherëshëm i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 07 datë: 29/09//2025

Nr. _____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. _____ datë ____/____/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin

“Për një ndryshim në VKB nr 08 datë 31.01.2025 “Për një shtesë në VKB nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025” për projektin “Enhancing the Capacities of Community Social Center “Zinxhira” to offer Specialized and Inclusive Services for Vulnerable (Përmirësimi i Kapaciteteve të Qendrës Komunitare Sociale “Zinxhira” për të ofruar Shërbime të Specializuara dhe Përfshirëse për Komunitetet e Cenueshme në Gjirokastrë (ZINXHIRA SOCIAL RISE)”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe VKB nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025”, i ndryshuar”

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Në kuadër të projektit të aplikuar nga Bashkia Gjirokastrë “Përmirësimi i Kapaciteteve të Qendrës Komunitare Sociale “Zinxhira” për thirrjen EU4SocialCare me CFP Reference: CEF/ALB/2024/004 të finalizuar në dhjetor 2024 me qëllim kryesor Për të zhvilluar dhe forcuar më tej Qendrën Sociale Komunitare "Zinxhira", përmirësimin e jetës së grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël në Gjirokastrë, me theks të veçantë për gratë, vajzat dhe djemtë viktimë të diskriminimit dhe abuzimit dhe në nevojë për mbrojtje, minoritetet romë dhe egjiptiane, individët me aftësi të kufizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta.

Bashkia Gjirokastrë në cilësinë e aplikuesit lider është kualifikuar si fituese në këtë thirrje me projektin : Enhancing the Capacities of Community Social Center “Zinxhira” to offer Specialized and Inclusive Services for Vulnerable (Përmirësimi i Kapaciteteve të Qendrës Komunitare Sociale “Zinxhira”).

Në cilësinë e Liderit Bashkia Gjirokastrë duhet të kryente procedurat e prokurimit publik me qëllim realizimin përfundimtar të aktiviteteve buxhetore të përcaktuar në buxhetin midis palëve. Në mbështetje të ligjit 162/2022 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Bashkia Gjirokastrë mori të gjitha masat për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për aktivitetet buxhetore. Sipas aktiviteteve të përcaktuara në buxhetin e projektit një nga aktivitetet buxhetore ka rezultuar i pasuksesshëm edhe pse si procedurë është rihedhur disa herë, kjo për mungesë të interesit publik për të marrë pjesë si konkurent në praktikën e publikuar.

Ndodhur në këtë situatë dhe duke qënë të kufizuar në kohë për realizimin e sukseshëm të projektit Donatori “UNICEF” ka sugjeruar për zgjidhjen e situatës që përgjegjësia për realizimin e aktivitetit buxhetor “Blerje mjeti për të ofruar shërbime të kontaktit në zona të largëta” t’i kalojë partnerit. Si rrjedhojë e diskutimeve të shumta është dakortësuar midis palëve që procedurën e realizimit të aktivitetit ta kryej partneri i projektit “IRCA” dhe në përfundim produkti përfundimtar t’i kalojë në formën e dhuratës përfituesit Bashkisë Gjirokastrë.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Për sa më sipër si dhe për efekt lehtësimi të procedurave të prokurimit dhe zbatimit në kohë të afateve të projektit aktiviteti A 1.1.4 në VKB nr 08 datë 31.01.2025, do të bëhet si më poshtë vijon:

Ishte:

Gr.00 Tit. AB115 Kap.5 Art 231 me kod projekti P043AAS “A1.1.4 Blerja e një automjeti për të ofruar shërbime të kontaktit në zonat e largëta (njësi lëvizëse)” në vlerën 2 359 751.58 ALL pa TVSH

Gr.00 Tit. AB115 Kap.4 Art 231 me kod projekti P043AAS “A1.1.4 T.V.sh Permirosimi i kapaciteteve te qendres komunitare sociale Zinxhira” në vlerën 471 950.32 ALL

Bëhet:

Gr.00 Tit. AB115 Kap.5 Art 604 me kod projekti V043AAK “Transfertë për realizimin e aktivitetit buxhetor A1.1.4” në vlerën 2 359 751.58 ALL

Gr.00 Tit. AB115 Kap.4 (1) Art 604 me kod projekti V043AAK “Transfertë për realizimin e aktivitetit buxhetor A1.1.4” në vlerën 471 950.32 ALL

Drejtoria / Sektori përgjegjës .

Drejtoria e Finances

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, sipas pershkrimeve ligjore dhe sa here ai e shikon te nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Ky projrkt vendim impakton grupe të marginalizuara dhe vulnerabël në Gjirokastrë, me theks të veçantë për gratë, vajzat dhe djemtë viktime të diskriminimit dhe abuzimit dhe në nevojë për mbrojtje, minoritetet rome dhe egjiptiane, individët me aftësi të kufizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta.

A është objekt i konsultimit publik:

Jo

Komisioni i Përhershëm i i **“Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”** i mbledhur me datën 29 / 09 /2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. _____ datë **30. 09** 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin:

“Për një ndryshim në VKB nr 08 datë 31.01.2025 “Për një shtesë në VKB nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025” për projektin “Enhancing the Capacities of Community Social Center “Zinxhira” to offer Specialized and Inclusive Services for Vulnerable (Përmirësimi i Kapaciteteve të Qendrës Komunitare Sociale “Zinxhira” për të ofruar Shërbime të Specializuara dhe Përfshirëse për Komunitetet e Cenueshme në Gjirokastër (ZINXHIRA SOCIAL RISE)”
.paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- ☒ b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
 - ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
 - ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
 - ✓ Paragrafi x (iks) i projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit


(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma) Sekretar i Komisionit

Datë 29 /09/ 2025